**PROTOKOLLI PËR ZBATIMIN**
**E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ARTISTIK MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim ASHAK), në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të nënshkruar ndërmjet tyre më 08.09.2000 në Tiranë, për vitet në vazhdim 2005 - 2007, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimtari të përbashkëta:

1. **Tubim shkencor "Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare" (kritika letrare dhe historia e letërsisë ).** ASHAK (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), në bashkëpunim me ASHSH (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), 2005-2007;
2. **Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë – veprimtari të Këshillit Ndërakademik.** Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHSH (IGJL) dhe ASHAK (SGJL) për harmonizimin e qëndrimeve në këtë fushë.
3. **Konferenca Shkencore "Leksikografia shqiptare" – botimi i materialeve.** Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL) dhe ASHAK (SGJL), 2005;
4. **Enciklopedia Shqiptare.** Projekt i përbashkët i dy Akademive, 2005 e në vazhdim;
5. **Enciklopedia e artit shqiptar.** Projekt i përbashkët i ASHSH (QSA) dhe ASHAK (SA), 2005 e në vazhdim;
6. **Fjalor me fjalë dhe me shprehje popullore.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL) dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, 2005 e në vazhdim.
7. **Fjalor i termave të informatikës.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IGJL dhe INIMA) dhe ASHAK (SGJL), 2005 e në vazhdim;
8. **Fjalor i botanikës. Fjalor i terminologjisë së botanikës dhe fjalori botanik shpjegues.** Hartimi dhe botimi i fjalorit. Projekt i përbashkët i ASHSH (IKB, FSHN dhe IGJL) dhe ASHAK (Seksioni i Shkencave të Natyrës), 2005 e në vazhdim;
9. **Veshjet popullore të Kosovës.** Vazhdim i korpusit të veshjeve popullore.Vëllimi V. Botim i përbashkët i Albumit përkatës. Instituti i Kulturës Popullore i ASHSH dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2005 e në vazhdim;
10. **Hasi – studim folkloriko-etnologjik.** Projekt i Institutit Albanologjik të Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Popullore të ASHSH, 2005 e në vazhdim;
11. **Kërkime arkeologjike në Kosovë.** Përpilimi i Hartës arkeologjike të Rrafshit të Dukagjinit, vëllimi I dhe II. Gërmime arkeologjike në Rrafshin e

Kosovës. Projekt i përbashkët i Institutit Arkeologjik të Tiranës dhe i Muzeut të Kosovës. (financim i përbashkët i këtyre institucioneve) 2005 e në vazhdim.

12. **Arkitektura popullore tradicionale shqiptare** (aspekti etnografik). Përgatitja e vëllimit II "Vendbanime dhe banesa popullore në Kosovë". Projekt i përbashkët i ASHAK (Seksioni i Shkencave Shoqërore) dhe ASHSH, 2005 e në vazhdim;
13. **Shkëmbime informacionesh në fushë të hidrometeorologjisë,** ndërmjet Institutit të Hidrometereologjisë Tiranë dhe ASHAK. 2005 e në vazhdim;
14. **Ekspozitë e anëtarit korrespondent Tahir Emra.** Projekt i ASHAK, në bashkëpunim me ASHSH dhe Galerinë Kombëtare të Arteve të Tiranës, Tiranë 2005;
15. **Projekt për ngritjen e shërbimit sizmologjik në Kosovë,** ndërmjet Instituti të Sizmologjisë Tiranë dhe ASHAK. 2005 e në vazhdim;
16. **Projekte për monitorimin e radioaktivitetit në mjedis, për analizat e përcaktimit të izotopeve radioaktivë në mostra mjedisore dhe teknologjike, etj.** ASHSH (IFB) dhe ASHAK (SSHN dhe Departamenti i Fizikës i FSHMN) 2005 e në vazhdim;
17. **Konferencë shkencore për 600 – vjetorin e lindjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skenderbeu.** ASHSH dhe ASHAK, Tiranë 2005;
18. **Konferencë shkencore për Faik Konicën.** Prishtinë, 2005.
19. **Konferencë shkencore kushtuar veprës së Anton Pashkut,** Tiranë 2005.
20. **Konferencë për veprën shkencore të Selman Rizës.** ASHAK (SGJL) dhe ASHSHS (IGJL), Tiranë, 2005;
21. **Konferencë shkencore për terminologjinë e gjuhës shqipe,** ASHAK (SGJL) dhe ASHSHS (IGJL), Tiranë 2006;
22. **Ekspedita të përbashkëta ndërdisiplinore,** 2005 e në vazhdim.
23. **Promovime veprash shkencore,** 2005 e në vazhdim.
24. **Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore,** 2005 e në vazhdim.

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet ose të shtohet me miratimin e të dy palëve.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.

Nënshkruar në Tiranë, më 22.02.2005, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**
**Akademik Eduard Sulstarova**

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

**SEKRETARI SHKENCOR**
**Akademik Hivzi Islami**

Kulturës Popullore i ASHSH dhe Instituti Arkeologjik i Prishtinës, 2005 e në vazhdim;

10. Hasi – studim historiko-etnologjik, Projekt i Institutit Albanologjik të Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Popullore të ASHSH, 2005 e në vazhdim;
11. Kërkime arkeologjike në Kosovë, Përpilimi i Hartës arkeologjike të Rrafshit të Dukagjinit, vëllimi I dhe II. Gërmime arkeologjike në Rrafshin e